LIGJ
Nr.7386, datë 8.5.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Penale të RPSSH, bëhen këto ndryshime:

Neni 9 ndryshohet si vijon:

"Mbrojtësi është personi i caktuar që ka për detyrë të ndihmojë të pandehurin në mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshne.

Mbrojtës mund të jenë:

Avokati, bashkëshorti i të pandehurit, si dhe gjinia e afërt i tij".

Neni 2

Pas nenit 9 shtohet neni 9/a me këtë përmbajtje:

"Avokati merr pjesë në hetuesi që nga njoftimi i akuzës së të pendehurit, si dhe në të gjitha fazat e shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Mbrojtësit e tjerë marrin pjesë vetëm në fazat e shqyrtimit gjyqësor".

Neni 3

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Pjesëmarrja e avokatit është e detyrueshme, kur:

A) i pandehuri është i mitur.

B) i pandehuri, për shkak të të metave fizike a psikike, nuk mund të realizojë vetë të drejtën e mbrojtjes.

Në këto raste heqja dorë nga mbrojtja është e pavlefshme".

Neni 4

Në nenin 14, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Avokati ka, gjithashtu të drejtë të takohet me të pandehurin, të njihet me të gjitha materialet e çështjes në përfundim të hetimit, t'u drejtojë pyetje të pandehurit dhe dëshmitarëve me lejen e hetuesit, për raste ballafaqimi, si dhe të marrë pjesë në kryerjen e veprimeve të tjera hetimore ku është i pranishëm i pandehuri".

Neni 5

Fjalët "këshilltar ligjor" që përmenden në këtë Kod, zëvendësohen me fjalën "avokat".

Neni 6

Në nenin 63, në paragrafin e tretë shtohen edhe veprat penale të parashikuara nga nenet 175,191,194 dhe 210 të Kodit Penal.

Neni 7

Në nenin 116, në paragrafin e parë, pas fjalëve “të gjitha çështjet”, hiqen fjalët “me përjashtim të atyre që me ligj janë lënë në kompetencën e gjykatave të fshatit, të qytetit ose të lagjes së qytetit”.

Neni 8

Neni 125 ndryshohet si vijon:

“Gjyqtari i vetëm, kur e çmon të arsyeshme, në çështjet që ndiqen mbi ankimin e të dëmtuarit akuzues, për të cilat nuk është arritur pajtimi nga gjykata shoqërore, bën përsëri përpjekje për pajtim dhe, kur arrihet pajtimi, mbahet procesverbal. Me këtë detyrë mund të ngarkohet edhe njëri nga ndihmësgjyqtarët. Procesverbali i pajtimit nënshkruhet nga palët dhe, sipas rastit, nga gjyqtari ose ndihmësgjyqtari që ka arritur pajtimin”.

Neni 9

Në nenin 126, në paragrafin e parë, pas fjalëve “e të dëmtuarit akuzues” shtohen fjalët “kur nuk është arritur pajtimi nga gjykata shoqërore”.

Neni 10

Në nenin 127 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë, shtohet neni 175 i Kodit Penal.
- Shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Për veprën penale të parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal, organet e punëve të brendshme i dërgojnë kallëzimet në këshillin popullor përkatës, ku vepron gjykata shoqërore”.

Neni 11

Në nenin 179, pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ministri i drejtësisë ka të drejtë të ushtrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të rretheve e të zonave”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1990.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA